



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRES
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 46, datë 23.07.2025

PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 1581683 (NJË MILION E PESËQIND E TETËDHJETË E NJË E GJASHTËQIND E TETËDHJETË E TRE) LEKË TË PARAFINANCUARA NGA PROJEKTI TERRAIN, PROGRAMI INTERREG IPA ADRION (2021-2027)

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 65/2022 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit European për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III)”, Ligjit nr. 73/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë, përfaqësuar nga Rajoni i Emilia – Romagna-s, dhe Komisionit Evropian, për programin Interreg (Interreg VI-B) IPA Adriatik – Jon”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.115, datë 24.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm 2025-2027”, Udhëzimit nr.10, datë 12.07.2024 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, Marrëveshjes së Partneritetit të nënshkruar ndërmjet Partnerit Lider Centre for Research and Technology Hellas/Hellenic Institute of Transport dhe institucionit të Bashkisë Durrës, nënshkruar më datë 15.11.2024, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Turizmit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Të miratojë përdorimin e fondit prej 1.581.683 lekë, të ardhur si parafinancim nga projekti TERRAIN. Ky fond do të përdoret sipas të dhënave në tabelën si më poshtë vijon:


Gr.	Kap.	Programi	Llog. Ekon	Kodi i programit	Kodi i institucionit	Emri i institucionit	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Fondi në lekë
00	2	Transporti publik	602	04570	2107001	Bashkia Durrës	Projekti TERRAIN	G107007	1.581.683

2. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 24.07.2025






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 511 / 10 prot.

Durrës, më 24.07.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.46 datë 23.07.2025 “Për miratimin e përdorimit të fondit prej 1581683 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e një e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë të parafinancuara nga projekti TERRAIN, programi INTERREG IPA ADRION (2021-2027)”,

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

